REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 325/20
Datë/Datum. 05.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Bibaj – Exp shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit ***01.06.2020***	Data e dorëzimit të raportit **05.06.2020**

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 26.05.2020, OE KS "Besa Security"shpk - Prishtine, ka parashtruar ankesë me nr: 325/20, kundër njoftimit për kontrate, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sigurimi fizik i objekteve institucionale te Komunes se Skenderajt – ri tender, me nr. të prokurimit: 643-20-961-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna Skenderaj.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 400 000.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 7, 9, 27, te LPP-se, si dhe neni 18.16, i RrUOPP-se.

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Te nderuar,

Pas publikimit te njoftimit për kontrate ne kemi bere shkarkim te Dosjes se Tenderit dhe dokumenteve tjera
përcjellëse te publikuara nga Autoriteti Kontraktues - K.K. Skenderaj, dhe ne momentin e leximit/vleresimit
te kerkesave/kritereve kemi pare se AK ka vendosur Kritere te cilat jane ne kundershtim te plote me dispozitat

e LPP-se dhe Udhezuesin Operativ per Prokurimin Publik.

AK ka bere shkeljen/mosrespektimin e Nenit 7, Nenit 9, Nenit 27 te LPP-se dhe Piken 18.16 te Udhezuesit Operativ per Prokurimit Publik, pasi qe ne Dosje te Tenderit pervec tjerash ka kerkuar edhe:

c) Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të përgjegjësisë sociale (në lëmin e sigurimit fizik), me Certifikata të Srneta Sedex dhe BSCI përgjegjshmëria sociale (valide).

3. Të dëshmohet me certifikatë 9001 2015, 18001 2007, Smeta Sedex dhe BSCI - (kopjet për secilën certifikatë).

Nga Autoriteti Kontraktues jane kerkuar sqarime shtese, eshte bere Kerkese per rishqyrtim te dosjes se tenderit me c'rast eshte kerkuar qe Certifikatat (Smeta Sedex dhe BSCI) te largohen ne teresi nga Dosja e Tenderit dhe nese eshte e nevojshme te inkorporohen ne kushtet specifike te kontrates finale.

E gjithe kjo nen arsyetimin qe kjo eshte hera e pare qe nje Autoritet Kontraktues kerkon Certifikatat e tilla ne aktivitetet e prokurimit qe kanc tc bcjnc mc ofrimin c shcrbimcvc tc sigurimit, tc paktcn nga viti 2011-2012 e deri me sot asnjehere nuk eshte kerkuar nje Dokument i tille nga Autoritetet Kontraktuese dhe eshte e pa mundur qe OE te i posedojne dokumentet ne fjale, per te cilat dokumente/certifikata e kane edhe te pa mundur te aplikojne dhe te pajisen me to per kete afat te shkurter kohor!

Autoriteti Kontraktues per kete kerkese/dokument, ne "Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit", te dates 21.04.2020, ka dhene arsyetimin si vijon:

"Pasi qe punetoret e sigurimit gjate nje periudhe te gjate nga kompani te ndryshme nuk jane trajtuar si duhet konform Ligjeve ne fuqi, andaj e kane parashikuar si te domosdoshme kontraktimin e nje kompanie profesionale",

Kompania jone ka reaguar per kete gje dhe ne kerkesen tone per ri-shqyrtim kemi deklaruar se: Pergjegjshmeria e OE nuk mund te matet me nje Certifikate te leshuar nga ndonje institucion, mirepo nese ne te kaluaren keni pasur probleme me trajtim te punetoreve te sigurimit konform Ligjeve ne fuqi, atehere ju lusim/rekomandojme qe kete qeshtje te e percaktoni ne forme deklarative nga ana e OE pjesmarres e cila do jete edhe pjese perberese e kontrates kryesore dhe ne rast se OE nuk respektojne kete qeshtje atehere te mirren masa nga AK dhe te kerkoj nga Inspektoriati i Punes qe konform Ligjeve ne fuqi te bej inspektimin e punedhenisit mbi respektimin e te drejtave te te punesuarve.

Andaj kjo do te ishte shume me e vlefshme dhe me efikase se sa posedimi i nje Certifikate e cila mund te mosperfillet dhe prap OE te kete ne posedim kete certifikate dhe per kete arsye do te ishte shum me efikase inspektimi nga inspektoriatet e punes.

Mirepo perseri AK nuk ka perfillur Kerkesen tone dhe ka parapare qe Aktivitetin ne fjale te e zhvilloj normalisht, AK me Vendimin e dates 14.05.2020 ka lene ne fuqi Njoftimin per kontrate te dates 01.04.2020!

Autoriteti Kontraktues ne kete aktivitet, me veprimet e bera ka bere: Trajtim diskriminues dhe jo te barabarte te Operatoreve Ekonomik

- Ka ekzekutuar aspekte te aktivitetit ne ate menyre qe reduktojne apo eleminojne konkurencen ne mes Operatoreve Ekonomik,
- Ka vendosur kerkese/kriter te perzgjedhjes qe ne ndonje menyre ka per qellim te favirizoje ose diskriminoje kunder njerit ose me shume Operatoreve Ekonomik,
- Nuk eshte siguruar te beje vleresim formal te nevojave, permes se cilave do te bente percaktim te nevojave duke perfshire, llojin dhe kushtet permbajtesore te kontrates publike, etj.
- Nuk ka percaktuar ne Dosjen e Tenderit specifikimet teknike te zbatueshme ne vendin tone, aty ku eshte e pershtatshme kerkesat ekzekutuese dhe mundesite e varianteve, etj.
- Ka vendosur kerkesa te vecanta, duke mos u siguruar qe ato kerkesa te mos shkelin parimet e Nenit 7 te LPP-se.

Gjate kesaj kohe ne jemi kujdesur qe permes Kompanive zyrtare certifikuese, konkretisht permes TUV NORD BULGARIA EOOD e cila perfaqeson TUV NORD CERT Gmbh, te pajisemi me dokumentet ne fjale, mirepo nga ta morem deklarim zyrtar se Standardi social BSCI (si i kerkuar nga Autoriteti Kontraktues) nuk eshte i klasiflkuar per auditim ne Republiken e Kosoves dhe si i tille eshte i pa realizuar!

Ne kete Ankese kemi bashkangjitur edhe dokumentin qe e deshmon nje gje te tille!

Gjithashtu certifikata tjeter qe mund te aplikohet edhe ne Kosove (Smeta Sedex) kerkon vizite fizike te auditorit nderkombatar, andaj duke pasur parasysh kohen e pandemise ne vendin tone i bie qe me kete kriter AK ka diskualifikuar kompanite tjera te sigurimit per certifikime te pazakonta, nga ato qe implementohen rregullisht e qe jane: si ISO 9001 cilesia e menaxhimit, ISO 45001 sigurise dhe shendetit ne pune dhe ISO 27001 e sigurise se informacionit.

Veprimi i tille i Autoritetit Kontraktues "K.K. Skenderaj", nuk respekton dispozitat e Ligjit per Prokurimin Publik te Republikes se Kosoves, akteve tjera dhe Rregullores/Udhezuesit Operativ per Prokurimin Publik, andaj permes kesaj Ankese kerkojme qe te kthehet tenderi ne Rivleresim, me çrast kriteret/kerkesat e AK-se nuk do jene ne kundershtim me ligjet e zbatueshme ne Republiken e Kosoves

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET (KERKESAT)

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

Pika 3.
a) Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë (në lëmin e sigurimit fizik), me ISO Certifikatë 9001 2015 (valide).
b) Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (në lëmin e sigurimit fizik), me ISO Certifikatë 18001 2007 (valide)
c) Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare të përgjegjësisë sociale (në lëmin e sigurimit fizik), me Certifikatë SA 8000 2014 (valide), si dhe certifikatat shtesë të Smeta Sedex dhe BSCI përgjegjshmëria sociale (valide)
Dëshmia dokumentare 3.

3. Të dëshmohet me certifikatë 9001 2015, 18001 2007, SA 8000 2014, Smeta Sedex dhe BSCI - (kopjet për secilën certifikatë).

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Ska hapje te ofertave

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A .

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues – Komuna Skenderaj, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është shërbim (kornize 36 muaj), me vlerë të madhe. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër njoftimit për kontrate, përkatësisht kontestohet pozicioni nr. 3, i kërkesave te kapacitetit teknik dhe profesional.

- Parashtruesi i ankesës përveç kërkesës për sqarim, ne afatin e parapare me LPP, i është drejtuar AK-se me kërkese për ri shqyrtim ku ka kërkuar qe te përjashtohet kërkesa për Certifikatat (Smeta Sedec dhe BSCI). Megjithatë AK, ka refuzuar kërkesën me arsyetimin kryesore se kërkesa e tille është mese e nevojshme për shkak te trajtimit jo te mire te punonjësve te sigurimit ne te kaluarën.

Përgjigje në Pretendimin ankimor-1: (Neni 113) Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se AK me aplikimin e kërkesës për Certifikata si te tilla detyrimisht qon ne kufizim te konkurrencës apo edhe favorizim te ndonjë operatori ekonomik te caktuar dhe si e tille bie ndesh me dispozitat e nenit 7, te LPP-se.

- AK, përmes vendimit kundrejt kërkesës për ri shqyrtim nuk ka dhëne ndonjë baze ligjore për aplikim te kërkesës se kontestuar nga parashtruesi i ankesës, por ka potencuar qe e njëjta është aplikuar pasi qe ne te kaluarën nuk janë trajtuar si duhet punëtoret e sigurimit fizik.

Lidhur me te drejtat dhe mbrojtjen e punëtoreve, ne Republikën e Kosovës ekzistojnë ligje dhe institucione te veçanta, kompetente për ketë qeshje, rrjedhimisht AK duhet te aplikoi kërkesa te cilat

janë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me natyrën dhe qëllimin e aktivitetit te prokurimit (shih nenin 51 te LPP-se).

Si përfundim propozimi ynë për AK-ne është qe te largoi certifikatat e kontestuaka nga parashtruesi i ankesës ne mënyre qe te zgjeroi konkurrencën dhe nëse nëse e shef te nevojshme mund te vendos kërkesa te veçanta për ekzekutim te kontratës ne kuptim te nenit 18, te RrUOPP-se.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar dhe te obligohet AK, qe konform nenit 53, te LPP-se te zgjas afatin për oferte dhe ti bej ndryshimet e mundshme ne dosje te tenderit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues –Komuna Skenderaj.
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - "Besa Security"shpk - Prishtine

1 —